



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Dhjetor 2022

12

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NËNSHKRUHEN 5 KONTRATA ME BASHKITË DHE 24 KONTRATA ME ORGANIZATAT RINORE/ PËR RININË ME QËLLIM FINANÇIMIN E HAPËSIRAVE RINORE DHE AKTIVITETEVE PËR TË RINJË SHQIPTARË

Nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, Alqi Kushi, **u nënshkruan kontratat me Bashkinë e Durrësit, Dibrës, Gjirokastrës, Kamzës dhe Lushnjës, si fitues të granteve nga Thirrja e dytë për Projekt-propozime Rinore**, që po financohet me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet AKR-së.

Në bashkitë e Dibrës, Kamzës dhe Lushnjës, me anë të këtij financimi do të kryhet **rikonstruktimi apo ndërtimi i një biblioteke** për qytetin, të konceptuara kështu jo vetëm si vende leximi, por edhe si hapësira multifunktionale, ku të rinjtë do të angazhohen në trajnime dhe bashkëbisedime të ndryshme. Ndërsa në bashkitë e Durrësit dhe Gjirokastrës, me anë të këtij financimi do të **ngrihen Qendra Rinore Multifunktionale** dhe më tej, me anë të mbështetjes nga bashkitë përkatëse, këto qendra do të plotësohen me aktivitete të vazhdueshme për të rinjtë, për t'u siguruar që oferta për të rinjtë në këto qytete të jetë gjithmonë më e lartë.

Gjithashtu u nënshkruan dhe kontratat me **24 organizatat rinore/ për të rinjtë, njëri prej të cilëve do të financohet plotësisht nga UNICEF Albania**. Organizatat rinore dhe për të rinjtë do të zhvillojnë aktivitete përgjatë 12 muajve në vijim në **nxitjen e novacionit rinor dhe aftësive digjitale** të shekullit të 21-të tek të rinjtë, në mbështetjen e **këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës**, si dhe shumë aktivitete të lidhura me mbështetjen e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve.



REALIZOHET CEREMONIA HAPËSE E PROGRAMIT KOMBËTAR TË EKIPEVE SPORTIVE ME PJESËMARRJEN E 10 MIJË NXËNËSVE TË 700 SKUADRAVE

Më 10 dhjetor u realizua **ceremonia hapëse e Programit Kombëtar të Ekipeve Sportive**, që përfshiu mbi **10 mijë nxënës të 700 skuadrave të volejbollit e basketbollit nga e gjithë Shqipëria**, të cilët tashmë kanë filluar stërvitjet për t'u përgatitur për kampionatet sportive dhe janë pajisur me uniformat e tyre sportive. Pjesë e kësaj feste u bënë dhe mbi **22 mijë pjesëmarrës**, prindër, gjyshër dhe mbështetës të ekipeve sportive si dhe **350 trajnerë të palodhur** që stërvitin me pasion dhe energji fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë. Ky ishte vetëm fillimi i këtij projekti, pasi vitin e ardhshëm të rinjtë e përfshirë do të marrin pjesë në kampionatet që do të zhvillohen në nivel bashkie, qarku dhe nivel kombëtar për volejboll dhe basketboll.

Në ndihmë të organizimit të këtij eventi, një kontribut të veçantë dhanë dhe **150 të rinj vullnetarë** nga shkolla të ndryshme të vendit. Ky program iu ofron të rinjve mundësinë që në orët mbas mësimit **të përfshihen në aktivitete sportive të organizuara në volejboll dhe basketboll**, duke u larguar kështu nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet si dhe duke promovuar mirëushqyerjen për jetesën e shëndetshme.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Dhjetor 2022

12

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



REALIZUAM "SHKOLLËN DIMËRORE - EDICIONI I DYTË" ME PUNONJËSIT RINOR DHE ANËTARËT E KVR-VE ME QËLLIM FUQIZIMIN E KAPACITETEVE RINORE DHE PËR RININË


Për të 2 dytin vit radhazi, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) zhvilluam **"Shkollën Dimërore" me punonjësit rinor të 61 bashkive dhe përfaqësues të 50 Këshillave Vendor Rinor**, me mbështetjen e UNDP-së, World Vision Albania dhe RAYS Albania. Përgjatë 3 ditëve, të rinjtë trajtuan çështje të ndryshme rreth **ngritjes së Këshillave Vendor Rinor (KVR), Strategjisë Kombëtare të Rinisë, politikave rinore, shkrimit të projekteve dhe mundësisë për aplikim në thirrjet e AKR-së**. Gjithashtu, ata patën mundësinë të argëtohen nëpërmjet aktiviteteve sportive artistike e kulturore, si dhe të njihen me njëri-tjetrin, për të krijuar miqësi afatgjata dhe të vërteta.

Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një **takim prezantues me Këshillin Vendor Rinor të Pogradecit**, së bashku me Kryetarin e Bashkisë, me qëllim diskutimin e mënyrave më të mira si kjo strukturë mund të shërbejë për të fuqizuar **rolin e të rinjve në proceset politikëbërëse** si dhe përfshirjen e më shumë aktiviteteve për të rinjtë në Pogradec.

MBAHET KONSULTIMI ME ORGANIZATA RINORE/ PËR RININË RRETH NGRITJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR RININË

Për të diskutuar rreth mënyrës **së ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar një diskutim të hapur me përfaqësues nga **organizatat rinore/ për rininë dhe aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile**.

Pikat kyçe për diskutim ishin mbi të dhënat që mund të përfshihen si pjesë e bazës së të dhënave si platformë ndërvepruese, si një iniciativë që synon rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes qytetare. Kjo do të shërbejë për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave nga organizatat rinore/për të rinjtë në proceset e politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor, si dhe për nevojat dhe punën e tyre. Gjithashtu edhe **për të rritur ndërveprimin e të rinjve me këto organizata**, qoftë si vullnetarë, praktikantë apo edhe si drejtues të ardhshëm.



KREMTUAM REALIZIMIN ME SUKSES TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS ME TË RINJTË E THIRRJES SË VII-TË

Për të kremtuar realizimin me sukses të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë bëri bashkë **praktikantët e Thirrjes VII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës**, më 20 dhjetor.

Gjatë këtij aktiviteti, të rinjtë ndanë me njëri tjetrin eksperiencat e përftuara gjatë praktikës tyre në **institucione të qeverisë qendrore, vendore, në shoqëri tregtare dhe në organizata jo-fitimprurëse**, qoftë në aspektin profesional, akademik apo edhe personale. Gjithashtu të rinjtë patën mundësinë të krijojnë njohje dhe ura të forta bashkëpunimi me të rinjtë e tjerë. Në aktivitet u zhvillua dhe një **punëtori e shkurtër rreth shkrimit të një letre motivimi dhe CV-je**, për të përforcuar njohuritë e të rinjve në këtë drejtim.

Në thirrjen e VII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës zhvilluan praktikën e tyre 457 të rinj përgjatë periudhës 12 shtator deri më 12 dhjetor 2022.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi